

AKT NORMATIV
Nr.3, datë 10.8.2009

PËR DËRGIMIN NË AFGANISTAN TË NJË KOMPANIE SHITESË, TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Dërgimin në Afganistan të një kompanie shtesë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit.

Neni 2

Misioni i autorizuar i kësaj kompanie është ruajtja dhe sigurimi i bazës, objekteve, personave të rëndësishëm, si dhe kryerja e shërbimeve në pikat e kontrollit.

Neni 3

Ushtarakët, që do të marrin pjesë, për ditët e qëndrimit në këtë mision, veç pagës mujore, do të marrin, për vështirësi shërbimi, edhe një shpërblim ditor, të njëjtë me atë të ushtarakëve, që dërgohen në mision, në përputhje me ligjin nr.8932, datë 26.7.2002 “Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit”, të ndryshuar.

Neni 4

Ky aktnormativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha